



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit
DREJTORIA E POLITIKAVE TE TRANSPORTIT RRUGOR

UDHËZIM

Nr. 1649, datë 16/08/1999

Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve
Ndryshuar nga:

- ▶ U1 Udhëzim nr. 14, datë 19.07.2007,
- ▶ U2 Udhëzim i përbashkët me MF nr. 2348, datë 23.04.2008,
- ▶ U3 Udhëzim nr. 9, datë 16.11.2009,
- ▶ U4 Udhëzim nr. 14, datë 17.06.2010.
- ▶ U5 Udhëzim nr. 16, datë 25.08.2010.
- ▶ U6 Udhëzim nr. 3453, datë 04.07.2016
- ▶ U7 Udhëzim nr. 7780/1, datë 24.5.2018
- ▶ U8 Udhëzim nr. 3, datë 03.02.2022
- ▶ U9 Udhëzim nr. 7, datë 03.08.2026

Në zbatim të neneve 9, 32 (paragrafi i dytë) 36, 38 dhe 83 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998
“Për transportet Rrugore”, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit,

UDHËZON:

Hyrje

- ▶ U6 Paragrafi “Hyrje” ndryshon si më poshtë:
- ▶ U9 Paragrafi “Hyrje” ndryshon si më poshtë:

Mjetet motorike të transportit rrugor të udhëtarëve janë të detyruar të kryejnë në kohë dhe me rezultat pozitiv kontrollin teknik të detyrueshëm, në përputhje me udhëzimin përkatës mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore. Gjithashtu, këto mjete rrugore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të plotësojnë dhe kushtet e tjera, që lidhen me sigurinë e udhëtarëve dhe komoditetin e udhëtimit të tyre, si më poshtë:

- ▶ U9 Emërtimi i titullit ndryshon si më poshtë:

I. Sigurimi i udhëtarëve dhe komoditeti gjatë udhëtimit me autobus, si dhe kushtet teknike të veçanta, dhe komoditeti për mjetet me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”

A. Sigurimi i udhëtimit

- ▶ U6 Në kapitullin IA “Sigurimi i udhëtimit”, shtohen pikat 11 dhe 12, me përmbajtje, si më poshtë:
- ▶ U9 Pika 11, e shkronjës “A”, “Sigurimi i udhëtimit”, riformulohet si më poshtë:

1. Autobusët që janë të pajisur me derë ose dritare emergjence nga prodhuesi duhet t’i

kenë ato funksionale. Pozicioni dhe mënyra e përdorimit të tyre u behet e njohur udhëtarëve, nëpërmjet mbishkrimeve mbi to.

2. Dyert e shërbimit të jenë me hapje të komanduar nga drejtuesi i mjetit në mënyrë automatike. Nëse drejtuesi i mjetit nuk i sheh ato, te ketë në kroskot aparat sinjalizimi ne gjendje pune, për te kontrolluar pozicionin e tyre gjate udhëtimit.
3. Në raste defektesh apo aksidentesh, kur drejtuesi i mjetit nuk ka mundësi komandimi të dyerve duhet të kenë mundësi hapje nga ana e udhëtarëve nëpërmjet shërbimit përkatës, ose në mënyrë mekanike.
4. Dyert e autobusëve qytetës te kenë të shkruar dukshëm brenda dhe jashtë autobusit hyrjet dhe daljet.
5. Në autobusët qytetës të jenë caktuar dhe shënuar dukshëm numri i vendeve të ulura dhe numri maksimal i udhëtarëve që mund të transportojnë.
6. Në autobusë nuk duhet të ketë shkaqe për dëmtimin e udhëtarëve si tehe të mprehtë, dysheme të zbuluara dhe me elemente rrëshqitëse, pajisje apo vegla pune rezerve etj. Tubat e mbështetjes së udhëtarëve ne tavan, korridore apo sedilje duhet të jenë të veshura me gomë, material antikorrodive, duralumin ose plastik.
7. Për autobusët për të cilët nuk paraqitet nga ana e subjektit, çertifikata e përputhjes (konformitetit) të tipit nga uzina prodhuese ose ajo e miratimit nga organi i autorizuar i vendit prodhues, verifikohet pozicioni i sedijes së drejtuesit të mjetit, lartësia dhe largësia e saj nga udhëtarët si dhe pozicionet dhe largësitë e sediljeve të udhëtarëve.
8. Të jenë të pajisur me kuti të ndihmës së shpejtë shëndetësore.
9. Të kenë zinxhirë për gomat gjatë udhëtimit në kushte bore apo ngrice.
10. Të kenë trekëndëshin e bllokimit të rrugës, ndriçues portativ dhe gome rezervë.
11. Të jenë të pajisur në çdo kohë me kompletin e pajisjeve për situata emergjente (fikse zjarri, çekiç për thyerje xhamash dhe prerje rripi sigurimi, etj.).
12. Autobusët, të cilët kryejnë transportin e udhëtarëve në linjat qytetëse, rrethqytetëse, ndërqytetëse, linjat e transportit ndërkombëtar dhe shërbimet e transportit të rastit/turistik të udhëtarëve, (ndërkombëtar dhe brenda vendit), duhet përveç derës së drejtuesit të autobusit të kenë minimalisht dy dyer, përfshirë daljen e emergjencës.

B. Komoditeti i udhëtimit

► **U6** Në kapitullin IB, pika 1 riformulohet si vijon:

1. Pamja e jashtme e autobusëve duhet të jetë e pastër, pa njolla e deformime apo shtypje të mbulesës së tyre dhe me ngjyrën sipas lejes së qarkullimit.

Mbi autobus nuk lejohet të vendosen shkrime të tjera, qofshin me karakter tregtar apo për çdo qëllim tjetër, përveç emrit të subjektit transportues (neni 23, i ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 56, i VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullore e zbatimit të Kodit Rrugor”, i ndryshuar).

Pamja e jashtme dhe e brendshme e autobusit është subjekt për përfitim të aktvlerësimit për plotësimin e kushteve në komoditetin e autobusëve në transportin e udhëtarëve.

Hapësira e brendshme e autobusit të jetë e pastër nga ana higjienike dhe me komoditetin e prodhimit.

2. Dritaret të jenë funksionale, me xhama origjinale, kristal, të temperuar, me korniza gome dhe mbrojtje nga dielli si perde, grila etj.
3. Sediljet të jenë komode, me sistem amortizimi, të veshura dhe ato me sistem rregullimi të kenë pajisje bllokuese funksionale.

4. Sediljet e autobusëve urbane të jenë të rregullt sipas tipit të prodhuar nga uzina përkatëse dhe në gjendje funksionale.
5. Dyshemeja, tavani dhe paretet anësore të jenë të veshura, në gjendje të mirë për të siguruar hermeticitetin e nevojshëm nga faktorët e jashtëm.
6. Të kenë ndriçim të brendshëm të korridoreve, në hyrje dhe dalje si dhe mbi sediljet, të komandueshme, funksionale dhe me sistem mbrojtje elektrike (siguresa) tërësore dhe parciale, sipas tipit përkatës të uzinës prodhuese.
7. Të jenë të pajisur me sistem ventilimi dhe ngrohje konform atyre të parashikuar për tipin përkatës nga uzina prodhuese dhe në gjendje pune.
8. Të kenë brenda vende për bagazhe të lehta si dhe kapacitete të mjaftueshme për bagazhe të tjera në vende të parashikuara nga uzina prodhuese. Ato duhet të jenë të sigurta dhe funksionale.

► **U1** Në kapitullin IB, pas pikës 8, shtohet pika 8a:

► **U6** Paragrafi i dytë i pikës 8.a, kapitulli IB “Komoditeti i udhëtimit”, ndryshon si më poshtë:

► **U7** Paragrafi i parë i pikës 8(a), të shkronjës “B”, të kapitullit I, riformulohet si më poshtë: **U7 është shfuqizuar me udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2022**

► **U7** Paragrafi i tretë, i pikës 8(a), të shkronjës “B”, të kapitullit I, riformulohet si më poshtë: **U7 është shfuqizuar me udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2022**

► **U9** Paragrafi i parë, i pikës 8.a i shkronjës “B”, “Komoditeti i udhëtimit”, ndryshon si më poshtë:

8.a Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit të autobusëve në transportin e udhëtarëve brenda vendit lëshohet çdo vit, pasi autobusi ka kryer me rezultat pozitiv kontrollin teknik, të detyrueshëm, në qendrën e kontrollit teknik, të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin dhe është i pajisur me një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik, në përputhje me udhëzimin përkatës mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore.

Akt – Vlerësimi i Komoditetit në Plotësimin e Kushteve të Komoditetit në Transportin e Udhëtarëve Brenda Vendit i nënshtrohen edhe autoveturat me 8+1 vende, të cilat janë të licencuara në shërbimin e transportit të udhëtarëve në linja të rregullta rrethqytetëse, në përputhje me nenin 17 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar”.

► **U3** Pika 9 e kapitullit IB ndryshon si vijon:

► **U6** Paragrafi i parë dhe i tretë i pikës 9, kapitulli IB, ndryshojnë si më poshtë:

► **U7** Paragrafi i dytë, i pikës 9 të shkronjës “B”, të kapitullit I riformulohet si më poshtë: **U7 është shfuqizuar me udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2022**

► **U7** Paragrafi i katërt, i pikës 9, të shkronjës “B”, të kapitullit I, riformulohet si më poshtë: **U7 është shfuqizuar me udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2022**

► **U9** Pika 9 e shkronjës “B”, “Komoditeti i udhëtimit”, riformulohet si më poshtë:

9. Autobusët e transportit ndërkombëtar dhe brenda vendit të udhëtarëve, në linja të rregullta, si dhe në shërbimet e transportit të rastit/turistik të udhëtarëve, duhet të jenë të pajisur me sistem kondicionimi dhe qendër zëri, në përputhje me tipin e miratuar. Çdo ndenjësë e autobusit, duhet të jetë e pajisur me rripin e sigurimit. Autobusët e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve në linja të rregullta, duhet të kenë dhe tualet (WC, lavaman të vogël dhe solucion pastrimi), në përputhje me tipin e miratuar, si dhe të jenë në gjendje funksionale. Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit të autobusëve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, lëshohet çdo vit, pasi autobusi ka kryer me rezultat pozitiv kontrollin teknik të detyrueshëm, në qendrën e kontrollit teknik të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin dhe është i pajisur me një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik, në përputhje me udhëzimin përkatës mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore. Autobusët e subjekteve të pajisur me licencë për transportin ndërqytetës të udhëtarëve duhet të kenë të vendosur dhe funksional një pajisje GPS-i.

► **U3**

Aneksi ekzistues i emërtuar “Akt – Vlerësimin Teknik “Për autobusë të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve”, zëvendësohet me Aneksin 1, bashkëlidhur udhëzimit me emërtimin si vijon: “Akt – Vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit, të autobusëve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve”.

► **U9** *Pas shkronjës “B”, shtohet shkronja “C”, me përmbajtje, si më poshtë:*

C. Aktivlerësimi teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”

Mjeti me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” (të shënuar në lejen e qarkullimit), për përdorimin e tij sipas destinacionit duhet të kryejë vlerësimin e kushteve teknike të veçanta dhe kushteve të komoditetit. Kur mjeti me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” i plotëson kushtet teknike të veçanta dhe kushtet e komoditetit i lëshohet dokumenti “Aktvlerësimi teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit”. Ky dokument lëshohet nga strukturat e varësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), pas kryerjes së kontrollit të mjetit (me paraqitjen e mjetit pranë QKT-ve) me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” dhe vlerësimit se mjeti i plotëson kushtet teknike të veçanta dhe kushtet e komoditetit sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim.

Modeli, pamja grafike, elementet identifikuese të institucionit lëshues, elementet e sigurisë dhe të dhënat që duhet të përmbajë dokumenti “Aktvlerësimi teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit” për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”, miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së.

Dokumenti i Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” lëshohet me afat vlefshmërie 1 (një) vit. Në rastet kur nuk plotësohen kushtet (elementet) e vlerësimit (mjeti rezulton me mangësi), ai duhet të riparohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike me kushte të plotësuar, duke kryer pagesën përkatëse të rivlerësimit. Mosplotësimi i kushteve ndalon përdorimin e mjetit në aktivitetet e autoshkollës dhe lejon qarkullimin e tij vetëm për në destinacionin e riparimit. Në rast të tejkalimit të afatit, mjeti do t’i nënshtrohet procedurës së vlerësimit nga e para për pajisje me Aktivlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit, kundrejt kryerjes së pagesës së plotë.

Vlerësimi për mjetet me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” kryhet përpara pajisjes së këtyre mjeteve me “Autorizim për t’u ushtruar në drejtimin e mjetit dhe për provën e praktikës” (sipas modelit të miratuar nga DPSHTRR-ja). Autorizimi për t’u ushtruar në drejtimin e mjetit dhe për provën e praktikës ka afat vlefshmërie të njëjtë me aktivlerësimin teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit.

Mjeti me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”, për vlerësimin nëse i plotëson kushtet teknike të veçanta dhe kushtet e komoditetit, i nënshtrohet kontrollit pranë qendrave të kontrollit teknik të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), përkatëse ku është e regjistruar autoshkolla, në pronësi të së cilës ndodhet mjeti që vlerësohet për plotësim të kushteve të sigurisë dhe komoditetit. Kontrolli do të kryhet nga përgjegjësi i degës së kontrollit teknik dhe një specialist i kontrollit teknik, sipas fushave përkatëse dhe llojit të mjetit, të përcaktuara në raportin e kontrollit të sigurisë dhe komoditetit për mjetet me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”.

Kriteret vlerësuese për mjetet me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” janë si më poshtë:

1. Verifikimin e kushteve teknike të veçanta

a) Mjeti me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” duhet të jetë në gjendje të mirë teknike dhe me të gjitha aparaturat dhe instrumentet funksionale (treguesi i kilometrazhit, sinjalet + drita, frenat e parkimit, rripat e sigurimit etj.);

b) Të jetë i pajisur me pedalet e dyfishta funksionale, përveç atyre të kategorisë “L” (sipas klasifikimit të mjeteve në nenin 47, pika 2, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, (në vijim “Kodi Rrugor”) për përshpejtim, shkëputje dhe frenim (gaz, friksion, frena) për mjetin rrugor mësimor me kuti shpejtësie manuale dhe për përshpejtim, dhe frenim (gaz, frena) për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë” me kuti shpejtësie automatike;

c) Të jetë i pajisur me pasqyrë të brendshme për kandidatin dhe pasqyra të brendshme të përshtatura për instruktorin, përveç atyre të kategorisë “L” (sipas klasifikimit të mjeteve në nenin 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

d) Të jetë i pajisur me pasqyra anësore të jashtme majtas dhe djathtas, të rregulluara për përdorim nga kandidati dhe pasqyra anësore shtesë të jashtme majtas dhe djathtas për përdorim nga instruktori, përveç atyre të kategorisë “L” (sipas klasifikimit të mjeteve në nenin 47, pika 2, të Kodit Rrugor).

2. Verifikimi i kushteve të komoditetit

a) Të ketë sedilje komode, me sistem rregullimi, me pajisje bllokuese funksionale dhe me rripa sigurie funksionale;

b) Të jetë me numër ndenjësesh dhe kapacitet maksimal sipas lejes së qarkullimit;

c) Të ketë pamje të jashtme të pastër, të rregullt, pa dëmtime apo deformime dhe me ngjyrën sipas lejes së qarkullimit, si dhe hapësirë të brendshme të pastër nga ana higjienike (për mjetet me hapësirë të brendshme);

d) Dritaret dhe dyert të jenë funksionale, me xhama origjinale (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

e) Dyshemeja, tavani dhe paretet anësore të jenë të veshura, në gjendje të mirë për të siguruar hermeticitetin e nevojshëm nga faktorët e jashtëm (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3, sipas klasifikimit të mjeteve në nenin 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

f) Sistemi i ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar, nëse ka të instaluar, sipas konstruksionit të firmës prodhuese të jenë në gjendje funksionale (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

g) Të jetë i pajisur me trekëndëshin e sigurisë për sinjalizimin në rrugë, në rast defekti (për mjetet e kategorisë M dhe N);

h) Të jetë i pajisur me një fikse zjarri, me afat të vlefshëm përdorimi (kolaudimi) (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

i) Të jetë i pajisur me kutinë e ndihmës së shpejtë (për mjetet e kategorisë L6 me kabinë të mbyllur, automjetet e kategorisë M1, M2, M3, N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të Kodit Rrugor);

j) Të jetë i pajisur me çekiç për thyerjen e xhamave, që shërben njëkohësisht edhe për prerjen e rripit të sigurimit në raste emergjence (për automjetet e kategorisë M2 dhe M3).

3. Verifikimi i informacionit në mjet (shenjave dalluese)

a) Të jetë i pajisur me shenjën dalluese (tabelën) “Autoshkollë”, sipas nenit 312, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, (në vijim “VKM-ja nr. 153, datë 7.4.2000”). Përmasa dhe lloji i shkrimit janë sipas figurës IV.1 (për mjetet e kategorisë M1) dhe figurës IV. 2 (për mjetet e kategorisë M2, M3, N2, N3 dhe O3, O4), të nenit 312, të VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000.

b) Në pjesët anësore të mjetit të shkruhen fjalët: autoshkolla dhe emri i subjektit (ose emri tregtar i subjektit), sipas përcaktimit të shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 56, të VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000.

II.Kriteret bazë për hartimin e rregullores së udhëtimit

► U6 Në kapitullin II “Kriteret bazë për hartimin e rregullores së udhëtimit”, pika 16 ndryshon si më poshtë:

► U6 Mbas pikës 19 shtohet pika 19/1, me përmbajtje si më poshtë:

► U9 Në kapitullin II, “Kriteret bazë për hartimin e rregullores së udhëtimit”, ndryshon pika 15, riformulohet pika 20 dhe shtohet pika 25, si më poshtë:

Transportuesit që kryejnë transport të rregullt udhëtarësh, në linje me itinerare dhe vendqëndrime të pandryshuara konform licencës së lëshuar për këtë qëllim e ofrojnë këtë shërbim kundrejt “Rregullores së Udhëtimit”.

Meqenëse ky shërbim me autobusë i kryer prej subjekteve transportues mund të jetë i veçantë si: qytetës, ndërqytetës, rrethqytetës dhe ndërkombëtare ose kombinimi i tyre, subjektet duhet të hartojnë vetë rregulloret e udhëtimit, të cilat duhet të ndodhen vazhdimisht në autobus dhe elemente të saj të rëndësishëm duhet të afishohen dukshëm brenda tij.

Kriteret bazë të detyrueshme për hartimin e rregullores së mësipërme që duhen mbajtur parasysh sipas specifikës së tyre nga subjektet transportuese janë si më poshtë:

1. Para nisjes autobusët duhet të jenë të larë dhe pastruar mirë.
2. Nisja e autobusëve bëhet brenda orarit të përcaktuar në biletë.
3. Çdo udhëtar duhet të ulet në vendin, numri i të cilit është shënuar në biletë.
4. Me përjashtim të autobusëve urbane (qytetës) nuk lejohet gjatë udhëtimit qëndrimi i udhëtarëve në këmbë.
5. Nuk lejohet transporti i udhëtarëve mbi numrin e vendeve të shënuar në lejen e qarkullimit, dhe për autobusët urbane mbi numrin maksimal të lejuar në të sipas përcaktimit në lejen e qarkullimit.
6. **Drejtuesit të mjetit** i ndalohet biseda gjatë udhëtimit me udhëtarë ose persona të tjerë. Ndalohet qëndrimi i udhëtarëve apo personave të tjerë në sedijen në krah të tij me përjashtim kur gjatë udhëtimit nga subjekti është caktuar **drejtues mjeti** i dytë ose (konduktor) faturino. Në autobus vendosen tabela “Mos i fol **drejtuesit të mjetit**”.
7. Nuk lejohet në ambientin e brendshëm të autobusit, vendosje e sendeve, mallrave, që bëhen pengesë për qarkullimin e lirë të udhëtarëve (në hipje dhe zbritje) apo mallra të rrezikshme që ndotin ambientin apo rrezikojnë jetën e udhëtarëve.
8. Sedilja e **drejtuesit të mjetit** duhet të jetë ndarë me një parapet nga ato që vijnë direkt mbas saj.
9. Në autobusë ndalohet pirja e duhanit. Në të vendosen tabela paralajmëruese “Ndalohet duhani”.
10. Në autobusët qytetës parashikohen me shënime përkatëse vend ulje për invalidë, nena me fëmijë, gra shtatzëna dhe të moshuar.
11. Në autobusët për transport brenda vendit dhe ato qytetës afishohen gjatë nisjes sipas nenit 71 të ligjit “Për transportet rrugore”.
12. Udhëtarët janë të detyruar t’i paraqesin organit të kontrollit apo policisë në çdo rast kur kërkohet prej tyre dokumentin e identitetit dhe biletën e udhëtimit.
13. Autobusët me përjashtim të rasteve urgjente ndalojnë vetëm në stacionet e përcaktuara në licencë. Stacionet e qëndrimit afishohen dukshëm në autobus.
14. Ndalohet përdorimi me tone të larta i radiove dhe kasetofonave nga udhëtarët ose **drejtuesi i mjetit** dhe çdo zhurmë tjetër që përbën shqetësim për udhëtarët e tjerë.

15. Në autobus shënohet në sipërfaqen ballore emërtimi i linjës dhe numri i autobusit në linjë. Forma dhe skica e paraqitjes miratohet nga Autoriteti Licencues.
16. Personat e caktuar për kryerjen e trans-portit, që janë në kontakt me udhëtarët, duhet:
- të jenë të pajisur me një dokument identifikues të dallueshëm qartë gjatë ushtrimit të shërbimit;
 - të jenë të aftë për të menaxhuar një situatë emergjente, vlerësimin e situatës për shmangien e ndërlikimeve të një aksidenti, thirrjen për ndihmë dhe dhënien e ndihmës së parë, reagimi në rast zjarri, evakuimi i udhëtarëve të autobusit, duke siguruar mbrojtjen e të gjithë udhëtarëve;
 - të informojnë udhëtarët lidhur me detajet e shërbimit të transportit të ofruar, përpara dhe gjatë udhëtimit (për çmimet dhe tarifat, kushtet e transportit, veprimet në rast të një situatë emer-gjence etj.);
 - të kenë njohuri mbi dispozitat ligjore për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të sanksionuara me ligjet specifike, me qëllim që kësaj kategorie personash t'u ofrohet shërbimi përkatës i nevojshëm;
 - drejtuesit e autobusëve duhet të jenë të pajisur me dokumentin e kualifikimit (certifikatën e aftësisë profesionale) dhe vazhdimisht duhet të kenë me vete dhe të afishuar në një vend të dukshëm të autobusit, numrat e telefonave të emergjencave civile (Policia e Shtetit, urgjenca mjekësore, shërbimi zjarrfikës etj.);
 - të evitojnë diskutimet me udhëtarët, duke mbajtur gjithmonë një qëndrim korrekt.
17. Koha e vlefshmërisë të rregullores se udhëtimit deklarohet. Për ndryshime nga kriteret e këtij udhëzimi brehen propozimet nga transportuesit dhe miratimi behet nga ministri.
18. Për linjat e transportit ndërqytetës përcaktohet kombinimi dhe vijueshmëria me linjat e tjera dhe ato hekurudhore apo ujore me te cilat transportuesi ka kontrate.
19. Për linjat ndërkombëtare përcaktohen pikat e kalimit kufitar.
- 19.1 Autobusët që kryejnë shërbimet e transportit të rastit/turistik, ndërombëtar dhe brenda vendit, duhet të kenë një tabelë në pjesën e sipërme të xhamit të përparmë (në krahun e djathtë të drejtuesit të mjetit), në të cilën, me shkronja kapitale të shkruhet "SHËRBIME TË RASTIT", ku lloji i germës Impact, lartësi shkrimi 9 cm. Tabela do të jenë me sfond të verdhë, shkrim të zi dhe dimensione 50 x 25 cm.
20. Rregullorja e udhëtimit për transportin qytetës/rrethqytetës/ndërqytetës mund të përpunohet dhe të përmbajë kërkesa dhe kushte të tjera përveç sa përmendëm në këtë udhëzim sipas marrëveshjes së transportuesit me organet e Autoritetit Licencues.
21. Transportuesi afishon rregulloren e miratuar të udhëtimit ose pjese të saj në të gjithë stacionet e linjës përkatëse dhe në autobusë. Ajo, me përjashtim të rregullores për transportin qytetës me autobusë, duhet të jete në autobus dhe i jepet nga drejtuesi i mjetit çdo qytetari me kërkesën e tij.
22. Rregullorja me këto kërkesa sipas llojit të transportit dhe specifikime të tjera të transportuesit ka në krye të saj emërtimin e subjektit transportues, adresën, nr. e telefonit si dhe firmën e vulën e administratorit ligjor të saj.
23. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për subjektet transportuese dhe udhëtarët dhe kanë objekt të kontrollit nga organi kompetent.
24. Subjektet transportuese brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtyre dispozitave, të marrin masa për hartimin e rregulloreve të udhëtimit, publikimin dhe

afishimin e tyre.

25. Autobusët e certifikuar për operim në transportin rrugor duhet të kenë të instaluar pajisjen e takografit digjital, të shoqëruar me formularin e instalimit të pajisjes. Për mjetet që kryejnë transportin e udhëtarëve mjetet duhet të jenë të pajisura me pajisjet e transaksionit digjital të biletimit. Këto pajisje janë objekt verifikimi nga Komisioni për sa i përket gjendjes fizike, numrit të identifikimit dhe elementeve të tjera të përcaktuara në formularin e instalimit të tyre. Mungesa e pajisjeve në mjetet e certifikuar, dëmtimi fizik i tyre, mospërputhja midis numrit të identifikimit të pajisjes dhe targës së mjetit, si dhe të dhënave të tjera të përcaktuar në formularin e instalimit përbën shkak për refuzimin e lëshimit të aktvlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit.

III. Mbi kushtet dhe rregullat e kryerjes së transportit të udhëtarëve me taksi

U9 Në kapitullin III, “Mbi kushtet dhe rregullat e kryerjes së transportit të udhëtarëve me taksi”, në pikën 1, numri “3.16” zëvendësohet me numrin “3.6”, si dhe bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Shërbimi taksi është transport rrugor publik që siguron transport të menjëhershëm të udhëtarëve dhe bagazheve të tyre deri në destinacion, duke zgjedhur itinerarin më të shkurtër, me mjete sipas nenit 3, pika 3.6 të ligjit.
2. Vendet e qëndrimit dhe nisjes së taksive përcaktohen me vendim të Këshillit të Bashkisë ► **U5** ose të Komunës dhe organeve të tjera kompetente si ato të aeroporteve, hekurudhave, porteve dhe agjencive të transportit urban dhe ndërkombëtar Brenda juridiksionit të tyre. Automjetet taksi në këto terminale zënë vend sipas radhës së ardhjes së tyre.

Vendet e caktuara nga bashkitë ose ► **U5** komunat janë të destinuara si vend nisjeje vetëm për taksitë në juridiksionin e këtyre bashkive ► **U5** ose komunës dhe të licencuara si të tilla.

► **U5** Nuk lejohet qëndrimi i një autoveture në shërbimin taksi, e licencuar në një njësi të qeverisjes vendore, në vendin e qëndrimit të autoveturave në shërbimin taksi të një njësie tjetër të qeverisjes vendore.

Taksitë e bashkive ► **U5** ose komunave tjera mund të lenë udhëtarë në këto vendqëndrime, por nuk mund të marrin udhëtarë prej andej.

3. Këshilli Bashkiak ► **U5** ose komunës përveç dispozitave të ligjit dhe këtij udhëzimi mund të përcaktoj me vendim të tij rregulla të tjera specifike me synim përmirësimin e këtij shërbimi, rregulla që kanë fuqinë vetëm brenda juridiksionit përkatës.

► **U1** Në kapitullin III, pika 4, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

4. Transporti i udhëtarëve i kryer në linjë të rregullt me anë të shërbimit taksi është i ndaluar. Autoveturat taksi nuk lejohet të qëndrojnë në stacionet e autobusëve të linjave të rregullta rrethqytetëse ose ndërqytetëse, por mund të marrin ose të sjellin udhëtarë, me qëllim shërbimin brenda qytetit. Ndalohet qëndrimi i autoveturave taksi dhe marrja e udhëtarëve në stacionet e autobusëve të linjave qytetëse.

Në rastin kur autovetura taksi kryen udhëtime jashtë rrethit, ku ajo është e regjistruar, pika e nisjes së autoveturës taksi është brenda juridiksionit të bashkisë, ku ajo është licencuar.

Kur autovetura taksi kryen shërbime jashtë rrethit, ku është e regjistruar, ajo lejohet

të marrë në kthim:

- a) udhëtarë vetëm në rrethin e regjistrimit të saj;
- b) të njëjtët udhëtarë, të cilët e kanë prenotuar ose rezervuar më parë, në vajtje, dhe që kanë hipur në rrethin e regjistrimit të saj.

Autovetura taksi mund të prenotohet nga udhëtari, nëpërmjet agjencisë, ose drejtë përsëdrejti nga ai në vendqëndrimin e taksive, ose në ecje e sipër, etj.

Shërbimi taksi jashtë territorit të njësisë administrative kryhet nga çdo mjet i licencuar pjesë ose jo e agjencive për transport udhëtarësh, në përputhje me udhëzimin e licencimit.

Në këtë rast, autovetura taksi duhet të pajiset edhe me Dokumentin e Udhëtimit në përputhje me Aneksin 3a të këtij udhëzimi.

Agjencia pajis me dokumentin e udhëtimit vetëm autoveturat e licencuara në shërbimin taksi.

Gjithashtu, organet e kontrollit në rrugë, në rastin e shërbimit me grup të prenotuar/rezervuar më parë janë të detyruara të kontrollojnë edhe dokumentet e identifikimit të udhëtarëve që përbëjnë grupin.

Autovetura taksi është e ndaluar të përdoret për qëllime personale të subjektit.

Autovetura e licencuar taksi, e cila kryen udhëtime bosh jashtë rrethit të regjistrimit të saj, me qëllim zëvendësimin e autoveturave të licencuar taksi, që prishen ose dëmtohen gjatë udhëtimit të tyre, lejohet të marrë udhëtarët e autoveturës të licencuar taksi të dëmtuar, ose të prishur. Në këtë rast, dokumenti i udhëtimit plotësohet me shënimet përkatëse nga agjencia nisëse, dhe miratohet gjatë udhëtimit të kthimit nga organet e kontrollit në rrugë.

Në rastin kur një person kryen shërbimin taksi i papajisur me licencë, ose me licencë të vjedhur, ose të falsifikuar, ose me dokumente udhëtimit të falsifikuar, organet e kontrollit në rrugë marrin licencën dhe mbajtësi i saj dënohet në përputhje me pikën 2, të nenit 85, të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Cilido subjekt i licencuar nga autoriteti kompetent në veprimtarinë e shërbimit taksi dhe që operon në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dënohet në përputhje me nenin 8 ose 68, të këtij ligji dhe pikën 3, të nenit 85, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Licenca, Akt – Vlerësimi i Kushteve në Shërbimin Taksi, Dëshmia e Taksistit dhe Dokumentit të Udhëtimit, në origjinal, do të mbahen gjithmonë me vete nga drejtuesi i autoveturës taksi dhe u paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë kërkohet nga ata.

5. Subjekti transportues që ofron shërbimin taksi përveç plotësimit të kërkesave në dispozitat e ligjit “Për transportet rrugore”, “Kodit Rrugor” dhe dispozitave të tjera ligjore për marrjen e licencës, duhet të plotësojë dhe këto kërkesa:

- a) Të ofroj shërbim të qytetëruar dhe marrëdhënie korrekte me udhëtarët.

- b) Të mbaj pastër në çdo kohë mjetin/mjetet e tij.

- c) Të sigurojë “Dëshminë e taksistit” nëpërmjet zyrave të shërbimit të DPSHTRR-së mbasi të ketë ndjekur një kurs formimi për taksistë, me kohëzgjatje 12 orë dhe të jetë shpallur fitues i një testimi ku të demonstrojë

aftësitë e tij në:

- Njohuri mbi ligjet në fushën e transportit dhe aktet në zbatim të tyre.
- Njohuri mbi ndihmën e shpejtë në rast aksidentesh ose arsye të tjera.
- Të ketë dhe njohë mirë hartën e qytetit ku kryhen aktivitetin kryesor, si dhe adresat e institucioneve kryesore publike, hotelet qendrat shëndetësore, turistike, etj.

Njohuritë minimale për një gjuhë të huaj ndërkombëtare (preferohet ajo angleze) janë një avantazh përzgjedhës.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor merr masat për hartimin e procedurave në zbatim të pikës 5, germa “c” e këtij kreu.

► **U1** Në kapitullin III, pika 7, ndryshohet si më poshtë vijon:

7. Dëshmia e Taksistit është dokument që vërteton se drejtuesi zotëron njohuri të mjaftueshme për kryerjen e shërbimit me mjete taksi dhe është pjesë përbërëse e dokumenteve për efekt licencimi në transportin e udhëtarëve me taksi. DPSHTRR-ja do të shërbejë si qendër trajnimit për kandidatë që kërkojnë të pajisen me Dëshmi Taksisti. Për marrjen e Dëshmisë, drejtuesi i autoveturës taksi duhet të ndjekë programin e trajnimit të detyruar, sipas aneksit 3, dhe t’i nënshtrohen një provimi. Testimi i njohurive teorike realizohet pranë DRSHTRR-ve, me kompjuter në programin elektronik të testimit për Dëshmi Taksisti. Testi i provimit gjenerohet nga kompjuteri për çdo provë në mënyrë të rastësishme dhe përbëhet nga 30 pyetje të formuluar rreth temave të programit. Për t’u shpallur fitues i provimit, aplikanti duhet të ketë dhënë të paktën 27 përgjigje korrekte nga 30 gjithsej. Kohëzgjatja e testimit të njohurive është 30 minuta.

Dëshmia e drejtuesit të autoveturës të licencuar taksi mund të pezullohet ose hiqet gjatë ushtrimit të aktivitetit të profesionit dhe, ose refuzohet në rastin e rinovimit të saj nga autoriteti kompetent, që e ka lëshuar atë, kur:

- a) hiqet licenca në shërbimin taksi;
- b) drejtuesi i autoveturës shkel dispozitat e ligjit nr. 8308, datë 18.03.1999, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, këtij udhëzimi e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të mësipërme;
- c) vërtetohet se drejtuesi i autoveturës taksi kryen shkelje ndaj detyrimeve në trajtimin e udhëtarëve;

Afati i vlefshmërisë së Dëshmisë së Taksistit është pesë vjet. Në këtë rast, DPSHTRR ja, para regjistrimit për kursin e formimit për taksistë për lëshimin, për herë të parë ose rinovimin e dëshmisë, i kërkon drejtuesit të automjetit taksi certifikatën mjekësore që vërteton që është i aftë nga pikëpamja mjekësore dhe psikologjike për kryerjen e veprimtarisë përkatëse, dëshminë e penalitetit, si dhe të mos ketë masë administrative aktive për pezullim apo heqje të leje drejtimit. Dëshmia e Taksistit është prej polikarbonati dhe modeli i saj tregohet në aneksin 3, pamja grafike, elementet identifikuese, elementet e sigurisë dhe mënyra e personalizimit, miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor merr masat për hartimin e procedurave, në zbatim të pikës 7 të këtij kapitulli.

8. Drejtuesit e mjeteve “Taksi” duhet të jenë pajisur me leje drejtimi të vlefshme të njëjës prej kategorive D1, D1E, D dhe DE, sipas dispozitave të Kodit Rrugor për këtë lloj shërbimi dhe:
 - a) Të mos kundërshtoj pajtimtarët përveç se kur:

- Ata duan të transportojnë lëndë toksike ose janë të dehur dhe nuk shoqërohen nga një i afërm i tyre.
 - Ka pajtimtarë më shumë se numri i vendeve të automjetit.
- b) Të mos bëj faturim ose arkëtoj vlera në kundërshtim me ligjin.
- Të mos kërkoj parapagim, me përjashtim kur vihet në dispozicion të personave zyrtarë ose privatë si vdekje, dasma dhe kur kërkohet rezervimi i taksisë.
- c) Të mos bëj seleksionim udhëtarësh në vend pritje me përjashtim kur në radhët e tyre ka invalidë, të verbër, të sëmurë, gra shtatzëna, pavarësisht nga radha e udhëtarëve që presin.
- d) Të ndërpresë udhëtimin kur e kërkon udhëtari duke qëndruar në anë të rrugës për jo më shumë se 15 minuta, përveç shkaqeve të renda.
- e) Të jetë i sjellshëm, i gatshëm dhe i shpejtë, me paraqitje të jashtme të pranueshme dhe të ndihmoj udhëtarët në ngarkim-shkarkimin e bagazheve.
- f) Të shërbej në rrugën më të shkurtër, me përjashtim kur udhëtari zgjedh një rrugë tjetër.
- g) Të ndërpres funksionimin e taksimetrit kur ndalon ose devijon rrugë për shkaqe furnizimi me karburant apo servili të domosdoshëm.
- h) Të dorëzoj në polici ose te poseduesi çdo gjë që lihet ose harrohet në automjet
- i) Të disponoj mjaftueshëm lekë për kthim restoje.
- j) Drejtuesit e dy automjeteve të para taksi në radhë të parë në vendqëndrime janë të detyruar të qëndrojnë brenda tyre, ose pranë tyre në vend të dukshëm.
- k) Të vendos përkrash taksimetrit në vend të dukshëm licencën.
- l) Të kërkoj ndihmën e organeve të policisë kur i kërkohet shërbimi jashtë kushteve të përcaktuara në ligj dhe në rrugë të papërshtatshme që sigurojnë udhëtimin dhe mjetin dhe ka mosmarrëveshje me udhëtarin.
- m) Në asnjë rast nuk lejohet sjellje e pahijshme ndaj udhëtarëve.
Denoncimi i tyre është objekt i shqyrtimit nga organet e shqyrtimit të kundërvajtësve dhe organe të tjera të parashikuara me ligj.
- n) Të paraqesë kur kërkohet me shkrim nga organet kompetente licencën dhe kur nuk është në përputhje me dispozitat ligjore ta dorëzoj atë brenda 5 ditëve nga dita e lajmërimit.
- p) Në rast aksidentesh që i ndodhin atij, është i detyruar të qëndroj menjëherë në vendin e aksidentit dhe të veproj sipas dispozitave të Kodit Rrugor. Të japë ndihmën e nevojshme dhe të transportoj të aksidentuarit dhe në aksidente ku ai nuk është i përzier.
9. Udhëtari duhet të shmangi të gjitha mundësitë që mund të sjellin probleme në sigurinë e udhëtimit dhe veçanërisht duhet:
- a) Të mos pengoj me lëvizjet e tij drejtuesin e mjetit gjatë udhëtimit.
 - b) Të mos përpiqet të hipë apo të zbresë kur mjeti është në lëvizje.
 - c) Të mos pijë duhan pa aprovimin e drejtuesit të mjetit.
 - d) Të mos hapë dritaret pa aprovimin e drejtuesit të mjetit.
 - e) Të jetë i rregullt në kohën kur bën pajtimin.
 - f) Të mos bisedoj me drejtuesin e mjetit për tema të papërshtatshme gjatë udhëtimit.

- g) Të mos ngacmoj asgjë që ka të bëj apo sjell pasoja në funksionimin e mjetit.
- h) Të kujdeset gjatë transportimit për fëmijët dhe bagazhet e hapura, si dhe për invalidët, gratë shtatzëna, të verbrit, etj gjatë udhëtimit të përbashkët ose t'u japë atyre përparësi në udhëtim.
- i) Të tregoj dokumentin e identitetit si dhe biletën apo faturën e udhëtimit kur e kërkojnë organet e kontrollit ose policia.

► **U1** Pas kapitullit III, shtohet kapitulli III/a:

III/a Dokumenti i udhëtimit dhe numri i udhëtimeve në muaj në operacionet taksi me kthim të plotë, Blloku i udhëtimit dhe Regjistri i dokumentit të udhëtimit

1. Autovetura e licencuar taksi, që kryen shërbimin *jashtë rrethit* të regjistrimit të saj, operon sipas shkronjës “b”, të pikës 4, të Kapitullit III, pajiset me dokumentin e udhëtimit nëpërmjet agjencive të licencuara për transport udhëtarësh.
- Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet në të gjithë kërkesat që përfshin, si: numrin e licencës së agjencisë; emrin, ose emrin tregtar të subjektit agjenci transporti; emrin, ose emrin tregtar të subjektit transportues; kodin dhe numrin e serisë së licencës së subjektit transportues; emërtimin e bashkisë; emrat e personave që udhëtojnë në grup; numrat e dokumenteve të identifikimit; emri i agjentit dhe nënshkrimi i tij; numri i telefonit të agjencisë dhe vula e agjencisë.
 - Dokumenti i udhëtimit lëshohet nga agjencia subjektit në shërbimin taksi mbi bazën e një marrëveshje kontraktuale ndërmjet tyre, ajo nuk ka të drejtë t'i lëshojë dokument udhëtimi subjekteve në shërbimin taksi të pa kontraktuar. Subjekti në shërbimin taksi nuk ka të drejtë të kërkojë dokument udhëtimi nga agjenci, me të cilat nuk ka lidhur marrëveshje kontraktuale.
 - Rastet e evidentuara në kundërshtim me paragrafin më sipër përbëjnë arsye deri në heqjen e licencës, për subjektin agjencia dhe atë në shërbimin taksi.
 - Agjencia është përgjegjëse për saktësinë dhe korrektësinë e plotësimit të listës të udhëtarëve. Drejtuesi i autoveturës taksi nuk mund të pranojë dokumentin e udhëtimit me korrigjime.
 - Drejtuesi i autoveturës taksi, pas kryerjes së shërbimit të prenotuar/rezervuar, kthen dokumentin e udhëtimit në agjencinë ku e ka tërhequr atë, menjëherë me përfundimin e shërbimit, duke ruajtur për vete një fotokopje të saj. Në rast se drejtuesi i autoveturës taksi nuk kthen dokumentin e udhëtimit, agjencia, që ka lëshuar këtë dokument, njofton zyrtarisht organet e kontrollit të cilat marrin masa në plotësimin e këtij kushti.
 - Blloku i udhëtimeve me kopjet e listës të udhëtarëve qëndron në agjenci dhe në çdo moment është subjekt kontrolli nga autoriteti kompetent që licencën agjencinë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor që lëshon bllokun e udhëtimit, si dhe organet e autorizuar me ligj.
 - Agjencitë e transportit të udhëtarëve janë të detyruara të dërgojnë informacion, Drejtorisë Rajonale të DPSHTR dhe bashkisë përkatëse, me listën për subjektet taksi, të cilat kanë kryer operacione të kthimit plotë sipas shkronjës “b”, të pikës 4, të Kapitullit III, të këtij udhëzimi, në dhjetëditëshin e parë të çdo muaji, për muajin paraardhës.
 - Organet e kontrollit në rrugë, në mënyrë të veçantë, duhet të ushtrojnë kontrolle nëse procedurat e operimit të autoveturës taksi janë të rregullta, ndaj të gjitha autoveturave taksi, të cilat në kthim, mbajnë në bordin e tyre udhëtarë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si autoritet kompetent, pajis me bllokun e udhëtimit, që përmban 25 fletë në dy kopje, agjencitë e transportit të udhëtarëve.
 - Çdo bllok dhe dokumenti i udhëtimit do të kenë të njëjtin numër. Fletët e bllokut krahas numrit të serisë së bllokut do të shoqërohen edhe me numrat nga 1 deri 25.
 - Të dhënat që kërkohen për t'u vendosur në kapakun dhe dokumentin e udhëtimit do të bëhen me shkrim të kuptueshëm dhe me shkronja kapitale.
 - Faqja e parë e kapakut të bllokut të udhëtimit (shiko Aneksin 4) duhet të plotësohet, nga autoriteti kompetent që e lëshon, sipas të gjitha kërkesave që përfshihen mbi atë.
 - Blloku i udhëtimit lëshohet në emër të një agjencie dhe nuk mund të transferohet te një subjekt tjetër agjenci.
 - Autoriteti Kompetent (DPSHTRR) që lëshon bllokun e udhëtimit do të regjistrojë të gjithë elementët si vijon:
 - a) Emërtimin e subjektit;
 - b) Adresën e vendndodhjes së agjencisë;
 - c) Kodin dhe numrin i serisë së liçensës për veprimtarinë në shërbimin agjenci;
 - d) Emrin i njësisë vendore që ka lëshuar liçencën në shërbimin taksi;
 - e) Numrin e telefonit dhe, ose faksit të agjencisë.
 - Blloku i udhëtimeve mund të pezullohet ose hiqet subjektit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në shërbimin agjenci dhe, ose refuzohet rilëshimi i një blloku të ri udhëtimesh nga autoriteti kompetent, në rastin kur:
 - a) hiqet licenca në shërbimin agjenci;
 - b) vërtetohet se subjekti agjenci nuk përmbush direkt ose indirekt detyrimet për zbatimin e legjislacionit në transportin rrugor dhe në mënyrë të veçantë atë për mënyrën e operimit të autoveturës taksi.
 - c) provohet se subjekti agjenci ka furnizuar me informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara nga organet e kontrollit ose autoritet kompetente të licencimit.
 - Blloku i ri i udhëtimit i lëshohet çdo subjekti agjenci të licencuar, vetëm, pasi ai kthen bllokun e udhëtimit të përfunduar në organin përkatës që e ka lëshuar atë me 25 fletët kopje të dokumenteve të udhëtimit/listave së udhëtarëve.
3. Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) pajis agjencitë me regjistër të veçantë vetëm për shërbimin taksi, sipas shkronjës “b)”, pikës 4, të Kapitullit III, të këtij udhëzimi.
 - Regjistri përmban 50 fletë, dhe shërben vetëm për regjistrimin e të gjithë autoveturave të licencuara në shërbimin taksi që kryejnë operacione sipas shkronjës “b)”, të pikës 4, të Kapitullit III, me grup të prenotuar/rezervuar më parë.
 - Regjistri plotësohet në të gjithë kërkesat që përfshin, si: numrin e bllokut dhe dokumentit të udhëtimit; emrin, ose emrin tregtar të autoveturës të licencuar taksi dhe të drejtuesit të saj; kodin dhe numrin e serisë së liçensës të subjektit taksi, itinerarin e udhëtimit; datën e nisjes dhe të kthimit, etj.

IV. Kushtet e veçanta të automjetit në shërbimin taksi

► **U9** Në kapitullin IV “Kushtet e veçanta të automjetit “TAKSI””, zëvendësohet emërtimi i kapitullit, si dhe bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Automjetet e shërbimit taksi përveç plotësimit të kushteve teknike për sigurinë e qarkullimit rrugor sipas dispozitave të Kodit Rrugor dhe akteve në zbatim të tij duhet të plotësojnë dhe këto kërkesa të veçanta:

1. Të ketë taksimetër në gjendje pune, të regjistruar, të plumbosur dhe të kolauduar nga autoriteti përkatës, vërtetuar me paraqitjen e librit në origjinal, i cili përmban datat, firmën dhe vulën përkatëse.
2. ► **U5** Përsa i përket pamjes së jashtme:
 - a) të kenë si rregull ngjyrën e verdhë ose ngjyrën ose kombinimin e ngjyrave të përcaktuar nga bashkia, ku subjekti është licencuar në shërbimin taksi;
 - b) në ndryshim nga shkronja “a” e kësaj pike, autoveturat në shërbimin taksi të licencuara nga bashkitë jo-qendër rrethi/komuna nuk duhet të kenë ngjyrën e verdhë; dhe,
 - c) autoveturat në shërbimin taksi të licencuara nga bashkitë jo-qendër rrethi/komuna nuk duhet të kenë ngjyrën ose kombinimin e ngjyrave të njëjtë me ngjyrën e autoveturave të licencuara në shërbimin taksi nga bashkitë qendër rrethi të njëjtë rreth.
- **U5.2/1** Autoveturat në shërbimin taksi në dyert anësore, përveç stampimit të fjalës “TAKSI”, të kenë të vendosura, në mënyrë të dallueshme, tarifat në shërbimin taksi, stemën e bashkisë/komunës, si dhe emërtimin e kodit sëbashku me numrin e serisë së licencës të bashkisë, ku subjekti taksi është licencuar në shërbimin taksi.
3. Për mjetet që janë pronë ose punojnë me qira për llogari të shoqërive transportuese, të shënohet në mesin e dyerve, emri i shoqërisë dhe Nr.telefonit. Lartësia e shkronjave të jetë mbi 90mm.
4. Mbi pjesën e sipërme të automjetit vendoset një tabelë e ndriçuar me mbishkrimin “TAKSI”. Nuk lejohet fiksimi magnetik ose pneumatik i tabelës.
5. Të ketë në çdo kohë kutinë e ndihmës së shpejtë dhe trekëndëshin e sinjalizimit për raste defekti në rrugë.
6. Në kushtet e udhëtimit në borë ose akull në rrugë, të jetë i pajisur me zinxhirë të paktën për një rrotë.
7. Sistemi i ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar në se ka të instaluar sipas konstruksionit të firmës prodhuese të jenë në gjendje funksionale.
- **U3** Pika 8, e kapitullit IV shfuqizohet.
- **U1** Në kapitullin IV, pas pikës 8 shtohet pikat 9, 10 dhe 11 si më poshtë vijon:
- **U7** Shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 9, të kapitullit IV, riformulohen si më poshtë: **U7 është shfuqizuar me udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2022**

ç) ► **U9** (shfuqizuar me udhëzimin nr. 7, datë 03.08.2026)

► **U5.9/1** ► **U9** (shfuqizuar me udhëzimin nr. 7, datë 03.08.2026)

► **U5.9/2** ► **U9** (shfuqizuar me udhëzimin nr. 7, datë 03.08.2026)

~~Aneksat 1, 2 dhe 3 ndryshohen sipas anekseve bashkëlidhur.~~ shfuqizuar me udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2022

10. shfuqizuar me udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2022

11. Në Aneksin 5 bashkëlidhur këtij Udhëzimi jepen modeli i kapakut të regjistrit të

dokumentit të dokumentit të udhëtimit, dhe aneksi 5a, që përfaqëson modelin e faqes së brendshme të regjistrit në të cilën regjistrohen dokumenti i udhëtimit për shërbimin taksi me grup të prenotuar/rezervuar më parë.

Dokumentet e përmendura në pikat 10 dhe 11 të këtij kapitulli, në bazë të pikes 1.8 të VKM nr. 473, datë 29.07.1998 “Për rregullat kryesore të veprimtarisë së agjencive të transportit të udhëtarëve dhe të transportuesve, që kryejnë transport me autobus”, ruhen nga agjencitë e transportit të udhëtarëve për pesë vjet.

12. Automjeti në shërbimin taksi duhet të jetë i pajisur me targat përkatëse të mjetit në shërbim taksi, sipas legjislacionit në fuqi.

13. Për ofrimin e një udhëtimi komod dhe të sigurt, automjeti në shërbimin taksi duhet të jetë i pajisur në çdo kohë me:

- a) bombol për fikjen e zjarrit, 1–2 kg, e cila duhet të jetë funksionale dhe brenda afatit të vlefshmërisë;
- b) çekiç për thyerjen e xhamave që shërben njëkohësisht edhe për prerjen e rripit të sigurimit në raste emergjence.

14. Të ketë sedilje komode me rripa sigurie funksionale, të pajisura me sistem rregullimi dhe me pajisje bllokuese funksionale.

15. Të jetë i pajisur në çdo kohë me gomë rezervë funksionale, të vendosur brenda mjetit dhe të gatshme për përdorim në rast zëvendësimi.

16. Tek autoveturat për transport udhëtarësh me mbi 4+1 deri në 8+1 vende duhet të jenë të vendosura në vende të dukshme, lehtësisht të dallueshme dhe të lexueshme, tabela dhe shenja informuese:

- Ndalohej duhani;
- Mos i fol drejtuesit të mjetit;
- Numri i vendeve ulur, numri i vendeve në këmbë, numri i vendeve në total;
- Emërtimi linjës, kodi i linjës dhe numri i autobusit;
- Shkrimi “HYRJE” dhe “DALJE” në dyert e autobusit sipas funksionalitetit përkatës;
- Stacionet e linjës sipas një harte apo diagrame qartësisht të lexueshme.

► **U1** Pas kapitullit IV shtohet kapitulli IV/a dhe IV/b:

Kapitulli IV/a

► **U9** Në kapitullin IV/A, pika 1, ndryshon si më poshtë:

1. Licencat për autoveturat në shërbimin taksi shtypen dhe emetohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Shpërndarja do të kryhet në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin rrugor. Modeli, pamja grafike, elementet identifikuese të institucionit lëshues, elementet e sigurisë dhe të dhënat që duhet të përmbajë licenca për mjetin në shërbimin taksi, përcaktohen dhe miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së.
2. Pajisja me *licencë rezervë* e një subjekti që ushtron veprimtarinë në shërbimin taksi dhe lëshimi i saj nga autoriteti kompetent bëhet në rastin kur:
 - a) kur një *licencë dëmtohet* rëndë. Në këtë rast, subjekti e kthen licencën e dëmtuar në bashkinë, si autoritet kompetent, që ia ka lëshuar atë, e cila e dorëzon atë në zyrën e transportit të qarkut që e përfshin në juridiksion. Licenca e dëmtuar konsiderohet e pavlefshme në rastet kur në të janë bërë të palexueshme specifikimet e mëposhtme:

ii emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;

iii nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;

iiii data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;

iiv kodi i qarkut dhe numri i serisë, dhe etj.

- b) kur një *licencë deklarohet e humbur ose e vjedhur*. Në këtë rast, subjekti pezullon veprimtarinë dhe brenda pesë ditëve bën denoncimin te autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, e cila merr masat e duhura për njoftimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Policisë Qarkullimit, Policisë Tatimore për licencën e humbur ose vjedhur shoqëruar me të gjithë specimenet që përmbahen në licencë.
- c) kur një autoveturë taksi ka *pësuar dëmtime të rënda* të pariparueshme, ose për arsye të ndryshme del nga qarkullimi dhe për këtë, subjekti pajiset me një autoveturë tjetër, ai e dorëzon licencën te autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, që ia ka lëshuar, i cili ia kthen zyrës së transportit në qark.
- ç) kur një licencë *humbet vlerën sipas dispozitave të nenit 7 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*, i ndryshuar, ose hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë në përputhje me nenin 8 të ligjit të mësipërm.

Për shkronjat “c” dhe “d”, subjekti është i detyruar të dorëzojë licencën te autoriteti kompetent që e ka lëshuar, e cila vepron si në shkronjën “a” më sipër.

Për të gjitha rastet e mësipërme, zyra e transportit në qark njofton DPSHTR-në dhe organet e tjera të kontrollit në rrugë për pavlefshmërinë e licencës së përdorur, e cila ka dalë jashtë përdorimit, me numrin përkatës të serisë dhe njëkohësisht njoftojnë për numrin e serisë së licencës së re, rezervë, që e zëvendëson atë. Në njoftim, vendoset emërtimi i bashkisë që e lëshon licencën e re, rezervë.

Kohëzgjatja e të gjithë procedurave për pajisjen e subjektit me *një licencë të re, rezervë* nuk duhet të kalojë 30 ditë nga marrja e njoftimit, për dëmtimin, humbjen ose vjedhjen licencës së autoveturës taksi.”.

Për zëvendësimin e një licence, për rastet e parashikuara në pikën 2 më sipër, ndalohet përdorimi i licencave nga kuota bazë.

IV/b Krijimi i regjistrit kombëtar të subjekteve në shërbimin taksi

1. Me qëllim zbatimin e këtij udhëzimi krijohet regjistri kombëtar për subjektet e licencuara në shërbimin taksi.
2. Regjistri kombëtar vendoset pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të dhënat që përmban regjistri kombëtar trajtohen dhe mbikëqyren vetëm nga personat përgjegjës të caktuar për këtë qëllim në përputhje me ligjin N. 8517, datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Informacioni i grumbulluar, për shkeljet në mënyrën e operimit të autoveturave taksi, ose shkelje të tjera serioze, nga organet e kontrollit në rrugë, autoritetet kompetente të licencimit, etj., dërgohet te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila i hedh në regjistër.

Regjistri kombëtar do të përmbaj të dhënat si më poshtë vijon:

- a) emrin dhe formën juridike të subjektit në shërbimin taksi;
- b) adresën e vendndodhjes së subjektit taksi;

c) emrin e drejtuesit të autoveturës taksi;

ç) numrin e serisë së licencës;

d) numrin, kategorinë dhe llojin e shkeljeve serioze dhe shkelje të vogla të përsëritura.

3. Gjithashtu, në regjistër do të hidhen të dhënat në lidhje me një subjekt në shërbimin taksi, licenca e të cilit është pezulluar ose anuluar. Në këtë rast këto të dhëna duhet të shoqërohen në regjistër me arsyet e pezullimit ose anulimit të licencës.”.

► U2 shfuqizohet kapitulli V. Zbatimi i tarifave dhe çmimeve

VI. Të tjera

► U6 Pikat 1 dhe 2, kapitulli VI, “Të tjera”, ndryshojnë si më poshtë vijon:

► U9 Në Kapitullin VI “Të tjera”, ndryshon pika 1 dhe shtohen pikat 4 dhe 5 si më poshtë:

1. Tarifat për kontrollin teknik të mjeteve të transportit publik të udhëtarëve, miratohen nga ministri përgjegjës për transportin rrugor.
2. Tarifat e transportit ndërqytetës dhe rreth-qytetës të udhëtarëve me autobus janë ato të miratuara me VKM-në nr. 66, datë 7.2.2007, “Për ndryshimin e tarifave të udhëtarëve”, të ndryshuar, ndërsa tarifa e llojit të biletës në transportin qytetas të udhëtarëve me autobus miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, në përputhje me nivelin e standardit të kërkuar për këtë shërbim.
3. Sqaruesi nr. 2548, datë 17.12.1996 i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe çdo dispozitë e akteve të tjera të mëparshme që bien ndesh me dispozitat e këtij udhëzimi shfuqizohen.
4. Në momentin e paraqitjes së palës së interesuar për pajisje me Aktivlerësim, mjeti duhet të këtë kontroll teknik të vlefshëm dhe për të janë të shlyera detyrimet përkatëse pranë DPSHTRR-së.
5. Automjetet që përdoren në transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve, për ofrimin e shërbimit duhet të zbatohen kushtet në zbatim të akteve ligjore për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

VII. Vlerësimi i mjetit

► U9 Shtuar kapitulli VII, “Vlerësimi i mjetit” me përmbajtje si më poshtë:

Mjeti paraqitet për vlerësim pranë qendrës së kontrollit teknik dhe në përfundim të tij lëshohet dokumenti:

1. Aktivlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit, për rastet kur mjeti plotëson kushtet e përcaktuara (kalues).
2. Raport Vlerësimi, për rastet kur mjeti nuk plotëson kriteret e përcaktuara (mjeti rezulton me mangësi). Ky raport vlerësimi i shërben subjektit për njohjen me kushtet që duhet të përmbushë në zbatim të legjislacionit në fuqi për pajisjen me aktivlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit. Mosplotësimi i kushteve ndalon përdorimin e tij në shërbimin e transportit të udhëtarëve dhe lejon qarkullimin e tij vetëm për në destinacionin e riparimit të mjetit. Mjeti me raport vlerësimi “mjeti rezulton me mangësi”, duhet të riparohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike me kushte të plotësuar, duke kryer pagesën përkatëse të

rivlerësim. Në rast të tejkalimit të afatit, mjeti do t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit nga e para për pajisje me aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit, kundrejt kryerjes së pagesës së plotë.

VIII. Dokumenti i aktvlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit

► **U9** Shtuar kapitulli VIII, “Dokumenti i aktvlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit” me përmbajtje si më poshtë:

Dokumenti i Aktvlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor pranë sporteleve të shërbimit të qendrave të kontrollit teknik në varësi të saj. Aktvlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin rrugor të udhëtarëve lëshohet:

- a) për mjetin autoveturë në shërbimin taksi me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin autoveturë në shërbimin taksi”;
- b) për mjetin autoveturë për transport udhëtarësh me më shumë se 4+1 deri në 8+1 vende me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin autoveturë për transport udhëtarësh me më shumë se 4+1 deri në 8+1”;
- c) për mjetin autobus në transportin brenda vendit me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin autobus në transportin rrugor brenda vendit të udhëtarëve”;
- d) për mjetin autobus në transportin ndërkombëtar me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin autobus në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve”;
- e) për mjetin në transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve me emërtimin: “Aktvlerësim për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin në transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve”;
- f) për mjetin me destinacion “Autoshkollë” me emërtimin: “Aktvlerësim teknik për plotësimin e kushteve të komoditetit për mjetin me destinacion apo përdorim “Autoshkollë”.

Ky dokument ka afat vlefshmërie 1-vjeçar (njëvjeçar) dhe përmban të dhëna të dokumentit, të dhëna identifikuese të subjektit dhe mjetit për të cilin lëshohet. Modeli, pamja grafike, elementet identifikuese të institucionit lëshues, elementet e sigurisë dhe të dhënat që duhet të përmbajë, miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së.

IX. Dublikata

► **U9** Shtuar Kapitulli IX, “Dublikata”, me përmbajtje si më poshtë:

Dublikata e aktvlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit mund të lëshohet me kërkesë të pronarit apo përdoruesit të mjetit (referuar lejes së qarkullimit dhe të dhënave në sistemin informatik të DPSHTRR-së) në rast humbjeje, vjedhjeje ose shkatërrimi të dokumentit original, me afat vlefshmërie të njëjtë me dokumentin e lëshuar më parë.

Dispozita kalimtare

► **U9** Në paragrafin “Dispozita kalimtare”, pas pikës 4, shtohen pikat 5 dhe 6 me përmbajtje si më poshtë:

1. Bashkitë jo-qendër rrethi/komuna do të licencojnë subjekte në shërbimin taksi, si dhe kontrolli teknik i kryer nga subjekti i autorizuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe komisioni i DPSHTRR në plotësimin e kushteve të komoditetit dhe

të veçanta do të kryejnë veprime, nëse autoveturat në shërbimin taksi në bashkitë jo-qendër rrethi/komuna kanë ngjyrë të verdhe ose ngjyrën ose kombinimin e ngjyrave të njëjtë ma autoveturat në shërbimin taksi bashki qendër rrethi, të të njëjtit rreth deri në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare të këtij udhëzimi.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor merr te gjithë masat e nevojshme që te njoftoj te gjithë personat fizik që zotërojnë autovetura private, që duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi të mos tjetërsojnë ngjyrën e autoveturës duke bërë të verdhë ose ngjyrë ose kombinim të ngjyrave të njëjtë me atë të autoveturave në shërbimin taksi të bashkive qendër rrethi.
3. Brenda 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, zotëruesit e autoveturave në përdorimin privat, me përjashtim të atyre të pikës 9/2, të cilat janë të bojatisura me ngjyrën e verdhe ose me ngjyre ose kombinim të ngjyrave të njëjtë me atë të autoveturave në shërbimin taksi në bashkinë qendër rrethi, do të tjetërsojnë ngjyrën e autoveturave të tyre.
4. Bashkitë qendër rrethi, jo-qendër rrethi e komuna bashkëpunojnë nga afër me organet përgjegjëse, si Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, subjektin e autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, policinë rrugore, policinë bashkiake dhe policinë tatimore në zbatim të këtij udhëzimi.
5. Dokumentet e lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi janë të vlefshme deri në momentin e përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.
6. DPSHTRR-ja merr masat e nevojshme nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi për përditësimin e procedurave tekniko-administrative dhe sistemeve informatike për ofrimin e shërbimit të aktivlerësimit për plotësimin e kushteve të komoditetit, brenda muajit janar 2027.

► **U5** Ky udhëzim do të hyjë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Sokol OLLDASHI

MINISTER

KONTROLLI I KOMODITETIT DHE SIGURISË SË UDHËTIMIT												
NË AUTOBUSAT E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE												
Subjekti				Targa				Modeli				
1 ELEMENTET E SIGURISË												
a) Dyert	Gjendja Fizike		Gjendja Funksionale		Komandimi /kontrolli Automatik		Vizualiteti nga Drejtuesi		Mundësi hapje nga Udhëtarët			
	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo		
	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐		
	<i>Dera e drejtuesit të mjetit</i>	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐		
	<i>Derë udhëtarit</i>	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐		
<i>Derë udhëtarit</i>	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐		
<i>Derë/Dritare Emergjence</i>	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐		
b) Elementet e emergjencës				Prezent		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara				
				Po	Jo	Po	Jo					
<i>Rrip sigurimi në çdo ndenjësë</i>				☐	☐	☐	☐					
<i>Kuti të ndihmës së shpejtë shëndetsore</i>				☐	☐	☐	☐					
c) Pajisjet Kundër Zjarrit				Prezenca Fizike		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara				
				Po	Jo	Po	Jo					
<i>Fikse zjarri</i>				☐	☐	☐	☐					
<i>Çekiç për thyerje xhamash</i>				☐	☐	☐	☐					
<i>Të tjera sipas manualit</i>				☐	☐	☐	☐					
1 _____				☐	☐	☐	☐					
2 _____				☐	☐	☐	☐					
3 _____				☐	☐	☐	☐					
				☐	☐	☐	☐					
d) Elemente faktor të rrezikshëm				Prezenca Fizike		Nëse "PO" shënime të detajuara						
				Po	Jo							
<i>Dëmtime në dyshe</i>				☐	☐							
<i>Elemente rrëshqitës</i>				☐	☐							
<i>Tuba mbështetës për udhëtarët</i>				☐	☐							
<i>Tehe të mprehtë</i>				☐	☐							
<i>Koridore të xhveshura</i>				☐	☐							
<i>Sedilje të xhveshura</i>				☐	☐							
<i>Ndryshime të brendëshme konstruktive nga tipi autobuzit</i>				☐	☐							
e) Pajisjet për udhëtim në kushte bore apo ngrice				Prezenca Fizike		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara				
				Po	Jo	Po	Jo					
<i>Zinxhirë dëbore</i>				☐	☐	☐	☐					
f) Pajisjet për sigurinë e parkimit në kushtet e difekteve në rrugë				Prezenca Fizike		Funksionale		Nëse "JO" shënime të detajuara				
				Po	Jo	Po	Jo					
<i>Trekëndësh bllokimi rruge</i>				☐	☐	☐	☐					
<i>Ndriçues portativ</i>				☐	☐	☐	☐					
<i>Gomë rezervë</i>				☐	☐	☐	☐					

2 ELEMENTET E KOMODITETIT

a) Komoditeti i ndenjësve	Prezenca Fizike		Funksional e	Nëse "JO" shënime të detajuara
	Po	Jo		
<i>Sistem amortizimi</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Sistem pozicionimi</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Veshje e përshtatshme</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Paisje bllokuese</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Vende për bagazhe të lehta</i>	☐	☐	☐	☐
b) Veshjet e brendëshme	Hermetike		Nëse "JO" shënime të detajuara	
	Po	Jo		
<i>Veshje në tavan</i>	☐	☐		
<i>Veshje në dyshme</i>	☐	☐		
<i>Veshje në paritet anësore</i>	☐	☐		
c) Dritaret	Prezenca Fizike		Nëse "JO" shënime të detajuara	
	Po	Jo		
<i>Xhama origjinale</i>	☐	☐		
<i>Korniza gome</i>	☐	☐		
<i>Mbrojtje nga dielli</i>	☐	☐		
d) Sistemi i informimit, ndriçimit dhe i kondicionimit të brendëshëm	Prezenca Fizike		Funksional e	Nëse "JO" shënime të detajuara
	Po	Jo		
<i>Të korridoreve</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Në hyrje dhe dalje</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Mbi ndenjës</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Sistem kondicionimi</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Sistem ngrohje</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Sistem ventilimi</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Qëndër zëri</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Informacioni Hyrje dhe Dalje (Tr. Qytetas)</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Numri i ndenjësve dhe kapacitet Max (Tr. Qytetas)</i>	☐	☐	☐	☐
e) Kushte specifike higjieno sanitare (Transporti Ndërkombëtar)	Prezenca Fizike		Nëse "JO" shënime të detajuara	
	Po	Jo		
<i>Set ËC</i>	☐	☐		
<i>Lavaman i vogël</i>	☐	☐		
<i>Kushte sanitare (uje, sapun...higjenzues)</i>	☐	☐		
f) Elementet e estetikës së jashtme	Deformime apo shtypje		Gërvishje apo njolla	Nëse "PO" shënime të detajuara
	Po	Jo		
<i>Sipërfaqja e jashtme e autobusit</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Uniformiteti i lyerjes së jashtme e kabinës sipas Lejes së Qarkullimit</i>	☐	☐	☐	☐
g) Elementet e Informacionit	Prezente		Përmasa të pranueshme	Shënime të detajuara
	Po	Jo		
<i>Emërtimi i shoqërisë/subjektit transportues</i>	☐	☐	☐	☐
<i>Informacione të karakterit tregtar</i>	☐	☐	☐	☐

KOMISIONI

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

KRYETARI

(emri, mbiemri, firma)

Lëshuar më ____ / ____ / ____ ; i vlefshëm deri më ____ / ____ / ____



► **U9** Shtuar Aneks 3

ANEKS 3

PROGRAMI

Moduli	Orë	Temat e detajuara
Hyrje në profesion	1	- Historia e shërbimit me taksi; - Roli dhe përgjegjësitë e taksistëve.
Rregulloret dhe licencat	2	- Kriteret ligjore për t'u pajisur me dëshmi taksisti, afatet dhe vlefshmëria; - Procedurat për marrjen e licencës, afatet dhe vlefshmëria; - Rregulloret lokale mbi shërbimin e taksisë.
Siguria rrugore dhe emergjencat	2	- Sinjalet rrugore treguese dhe drejtimi i sigurt i mjetit taksi; - Mënyra e veprimit në rast aksidenti; - Përdorimi i pajisjeve të sigurisë.
Shërbimi ndaj klientëve	1	- Teknikat e komunikimit efektiv; - Menaxhimi i ankesave dhe konflikteve në mënyrë profesionale; - Shërbimi me etikë dhe respekt.
Gjeografia dhe navigimi	1	- Njohuri mbi rrugët dhe pikat e interesit - Përdorimi i GPS-it dhe hartave; - Planifikimi i itinerarit më të përshtatshëm.
Menaxhimi i mjetit	2	- Kushtet e veçanta që duhet të plotësojnë automjetet e shërbimit taksi; - Mirëmbajtja e mjetit; - Kontrolli i sigurisë së mjetit; - Rregulloret për transportin e pasagjerëve.
Aspektet ekonomike dhe fiskale	2	- Llogaritja e tarifave dhe procedurat e pagesës; - Menaxhimi i financave dhe shpenzimeve; - Rregulloret fiskale për taksistët.
Etika profesionale	1	- Sjelljet etike në punë; - Respekti për privatësinë e klientit.
Totali	12	

Modeli i dëshmisë së taksistit



Aneksi 4

Model i bllokut të dokumentit të udhëtimit/listës së udhëtarëve në shërbimin taksi

(letër me ngjyrë jeshile: A5 □ 14.72 cm x 21 cm)

(Kapaku, faqja e parë) Numri serisë (Libri Nr.)

Shërbimi taksi me grup të

prenotuar/ rezervuar LIBRI I

DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT

Për transportin rrugor të udhëtarëve në shërbimi taksi jashtë rrethit të regjistrimit të autovecurës taksi në përputhje me shkronjën “b”, të nenin 37, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar.

Emri ose emri tregtar i agjencisë së transportit:

.....

.....

.....

.....

Adresa:.....

.....

.....

.....

.....

...

(Agjencia që merr bllokun)

(Firma dhe vula e autoritetit që lëshon bllokun)

Aneksi 4

Ana e pasme e faqes së parë (kapakut) të modelit të bllokut të dokumentit të udhëtimit/listës së udhëtarëve

(letër me ngjyrë jeshile; Format: A5 □ 148.5cm x 105cm)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Blloku i lëshohet vetëm agjencive të transportit të udhëtarëve të licencuara nga autoriteti kompetent, në përputhje me kapitullin III/1 të këtij Udhëzimi.
2. Blloku nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
3. Blloku i ri tërhiqet pranë autoritetit kompetent që e lëshon atë vetëm pasi dorëzohet blloku i përdorur.
4. Blloku i udhëtimeve mund t'i pezullohet ose hiqet subjektit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në shërbimin agjenci dhe, ose refuzohet rilëshimi i një blloku të ri udhëtimesh nga autoriteti kompetent, në rastin kur:
 - hiqet licenca në shërbimin agjenci;
 - vërtetohet se subjekti agjenci nuk përmbush direkt ose indirekt detyrimet për zbatimin e legjislacionit në transportin rrugor dhe në mënyrë të veçantë atë për mënyrën e operimit të autoveturës taksi;
 - provohet se subjekti agjenci ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara nga organet e kontrollit; ose
 - kur veprohet në kundërshtim me këto dispozita.
5. Dokumenti i udhëtimit (dokumenti i prenotimit/rezervimit) është i vlefshëm vetëm në rastin kur, autovetura taksi kryen shërbime **jashtë territorit të rrethit**, ku është regjistruar dhe është prenotuar/rezervuar më parë nga një grup udhëtarësh, që hipin në bashkinë ku autovetura taksi është licencuar. Në këtë rast, ajo lejohet të transportojë në kthim vetëm grupin e udhëtarëve që e kishin prenotuar/rezervuar më parë atë.
6. Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet në të gjithë kërkesat që përfshin, si: numrin e licencës së agjencisë; emrin, ose emrin tregtar të subjektit agjenci transporti; numrin e telefonit të agjencisë; emrin, ose emrin tregtar të subjektit transportues; kodin dhe numrin e serisë së licencës së subjektit transportues; emërtimin e bashkisë; emrat e personave që udhëtojnë në grup; numrat e dokumenteve të identifikimit; emri i agjentit dhe nënshkrimi i tij; numri i telefonit të agjencisë dhe vula e agjencisë.
7. Dokumenti i udhëtimit i paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë që kërkohet prej tyre. Organet e kontrollit në rrugë pas verifikimit janë të detyruar të vendosin emrin mbiemrin dhe ta nënshkruajnë atë.
8. Blloku i udhëtimeve me kopjet e listës të udhëtarëve qëndron në agjenci dhe në çdo moment është objekt kontrolli nga institucionet që licencojnë agjencitë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor që ka lëshuar bllokun e udhëtimit si dhe organet e institucioneve që ia lejon ligji.
9. Autovetura taksi, e cilat kryen udhëtime bosh jashtë bashkisë ose rrethit të regjistrimit të saj, me qëllim zëvendësimin e autoveturave taksi që prishen ose dëmtohen gjatë udhëtimit të tyre, lejohet të marrë udhëtarët e autoveturës taksi të dëmtuar ose të prishur. Në këtë rast, dokumenti i udhëtimit plotësohet me shënimet përkatëse nga agjencia nisëse, dhe miratohet gjatë udhëtimit të kthimit nga organet e kontrollit në rrugë.”.
10. Drejtuesi i autoveturës taksi, pas kryerjes së shërbimit të prenotuar/rezervuar, kthen dokumentin e udhëtimit në agjencinë ku e ka tërhequr atë, menjëherë me përfundimin e shërbimit, duke ruajtur për vete një fotokopje të saj. Në rast se drejtuesi i autoveturës taksi nuk kthen dokumentin e udhëtimit/listën e udhëtarëve organet e kontrollit në rrugë marrin masa për pezullimin e aktivitetit të tij deri në plotësimin e këtij kushti.

Aneksi 4a

Dokument i udhëtimit

(letër me ngjyrë të bardhë: format A5 □ 14.9 cm x 10.5 cm)

Nr. Serisë bllokut shoqëruar me nr. serisë fletës.....

Nr.Liçencës të agjencisë dhe afati vlefshmërisë.....

Numri telefonit të agjencisë nisëse.....

Emri ose emri tregtar i subjektit agjenci transporti:.....

Emërtimi i bashkisë që ka lëshuar licencën taksi:.....

Vendndodhja e agjencisë:.....

Emri i drejtuesit të autoveturës kur është operator transporti
taksi:.....

Emri taksistit pronar transportues:.....

Numri i serisë së Liçencës së subjektit transportues taksi:.....

Dokumenti i Udhëtimit me grup të prenotuar/rezervuar

Itinerari i udhëtimit me të gjitha ndryshimet në se ka gjatë

udhëtimit:.....

.....

Bashkia nga ku niset taksia dhe data e nisjes	Vendi i destinacionit dhe data e mbërritjes	Km me ngarkesë	Km pa ngarkesë
Emri dhe Mbiemri i udhëtuesit		Numri i Dokumenti të Identifikimit/ çertifikatë me fotografi të personit/personave të udhëtimit	
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			

(Emri i nëpunësit të agjencia nisjes)

Emri, Mbiemri i Nëpunësit të Kontrollit
Në nisje

Emri, Mbiemri i Nëpunësit të Kontrollit
Në kthim

Shënim: Ky dokument mbahet në origjinal gjatë udhëtimit dhe është i vlefshëm vetëm në rastin për shërbim të prenotuar/rezervuar, dhe vlen për një udhëtim.

Të gjithë udhëtarët duhet të jenë të pajisur me dokumenti identifikimi.

Drejtuesi i autoveturës i paraqet këtë dokument organeve të kontrollit në rrugë, në nisje dhe në kthim, të cilët janë të detyruar të plotësojnë me emrin mbiemrin dhe nënshkrimin.

Aneksi 5

Kapaku (Faqja e parë)

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT
RRUGOR**

REGJISTRI I LISTËS SË UDHËTARËVE PËR SHËRBIMIN TAKSI ME GRUP TË PRENOTUAR/REZERVUAR

(letër me ngjyrë jeshile: A3 = 42 cm x
29.4 cm)

Aneksi 5a

Faqja e dytë

REGJISTRI I LISTËS SË UDHËTARËVE PËR SHËRBIMIN TAKSI ME GRUP TË PRENOTUAR/REZERVUAR

(letër me ngjyrë të bardhë: DIN A4)

(Kapaku, faqja e pare)

Numri serisë (Libri Nr.)

[illegible]